

BASHKIA KORÇE

NR 8216 PROT
DATA 20/08/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2025-2030, BASHKIA KORÇË.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjin 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjin nr. 47/2018 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligjin 18/ 2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", Ligji 22/2018 "Për strehimin social", Ligjin 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH, Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin nr.9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi, Bashkia Korçë ka hartuar Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore për periudhën 2025-2030.

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjiniore të Bashkisë Korçë u mundësua nga mbështetja e organizatës jo-qeveritare UN Women Shqipëri, në kuadër të Projektit "Bashkimi

Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i UN Women në Shqipëri është të promovojë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, duke siguruar të drejta e mundësi të barabarta për gratë dhe vajzat dhe duke kontribuar për një shoqëri më të barabartë, të sigurt dhe gjithëpërfshirës në Shqipëri.

Gjithashtu Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht:

- (1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- (2) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- (3) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
- (4) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.


Financimi i shërbimeve është parashikuar gjithashtu në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe në pikën 2 të VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social", sipas të cilit çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: (a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (b) fondet nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; (c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; (ç) tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Korçë ka mision garantimin e të drejtave dhe barazisë reale për të gjitha/gjithë qytetarët dhe qytetarët e saj, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

Për të gjitha këto arsye, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030.

Drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore Drejtore e Kujdesit Social Drejtore e Financës, Buxhetit dhe MFK

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)




Mariana Jorgji



Valbona Ziko

Në mungesë dhe me urdhër
Denada Tabaku



KRYETARI I BASHKISË

Sotirag Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2025

***PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2025-2030, BASHKIA KORÇË***

Në zbatim të Ligjit 139/2015” Për Vetqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9970 datë 24.07.2008 “ Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “ Për mbrojtjen nga diskriminimi “ , Ligjit nr. 47/2018” Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligjit 18/ 2017 “ Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, Ligjit 22/2018 “ Për strehimin social”, Ligjit 15/2019 “ Për nxitjen e punësimit”, Ligjil 57/2019 “ Për asistencën sociale në RSH, Ligjit nr. 68/2017 “ Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin nr.9936/2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi, dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

- 1- Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030, Bashkia Korçë.
- 2- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2025

***PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2025-2030, BASHKIA KORÇË***

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjit 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjit nr. 47/2018 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligjit 18/ 2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", Ligjit 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin nr.9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi, dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030, Bashkia Korçë.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____